



Shtojca I

MANUALI OPERATIV PËR PROGRAMIN E GRANTEVE PËR MBËSHTETJE TË ARSIMIT DUAL

Skema e granteve të inovacionit për promovimin dhe zbatimin e Arsimit Dual

Kjo skemë e granteve realizohet me mbështetjen e projektit "Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë", financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe implementohet nga MINTI përmes KIESA dhe LuxDev

PROGRAMI I GRANTEVE PËR MBËSHTETJE TË ARSIMIT TË DUAL

1.	HYRJE DHE KONTEKSTI I SKEMËS SË GRANTEVE	3
2.	OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITSHME TË THIRRJES PUBLIKE	3
2.1.	Objektivi kryesor i skemës së granteve.....	3
2.2.	Objektivat specifike të skemës së granteve të inovacionit.....	3
3.	Struktura e skemës së granteve	4
3.1.	Rezultatet e pritshme	4
4.	PËRFITUESIT E SYNUAR:	5
5.	SEKTORËT ME PRIORITET DHE OFERTAT	5
6.	MBËSHTETJA FINANCIARE QË OFROHET NGA AUTORITETI KONTRAKTUES..	6
7.	PRANUESHMËRIA E PËRFITUESVE TË GRANTEVE dhe KRITERET E	
	KËRKUARA për konsorciume dhe dorëzimin e propozimeve	6
7.1.	Kriteret e kërkuara për kompanitë/bizneset private	6
7.2.	Kriteret e kërkuara për institucionet e AAP-së.....	6
7.3.	Kërkesat për ofruesin/ët privatë të trajnimeve	6
7.4.	Kërkesat e kriterëve për konsorciumet.....	6
7.5.	Aplikacionet që nuk mund të kualifikohen për skemën e granteve	7
7.6.	Lista e dokumenteve që duhen dorëzuar	7
7.6.1.	Dokumentet shtesë që kërkohen:	8
7.7.	Kërkesat dhe sqarimet për dorëzimin e propozimit	8
8.	AFATET DHE KUSHTET.....	9
8.1.	Shpenzimet e pranueshme	9
8.2.	Shpenzimet e pa pranueshme	11
8.3.	Pranimi/pranueshmëria e shpenzimeve	11
8.4.	Kohëzgjatja.....	11
8.5.	Bashkë-financimi	11
8.6.	Kushtet e pagesës duke përfshirë bashkë-financimin	12
9.	QEVERISJA DHE MBIKËQYRJA E SKEMËS	12
10.	RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....	13
10.1.	Monitorimi dhe Komisioni i monitorimit.....	13
10.2.	Mbyllja e projektit.....	14
11.	PROCESI I VLERËSIMIT DHE KRITERET PËR VLERËSIMIN	14
11.1.	Procesi i vlerësimit	14
11.2.	Komisioni vlerësues	15
11.3.	Kriteret e vlerësimit të aplikacioneve për Dritaren 1	15
11.4.	Kriteret shtesë të vlerësimit për Dritaren 2	16
12.	Procedurat e aplikimit dhe afati kohor.....	16
12.1.	Procedurat e aplikimit	16
12.2.	AFATI PËR APLIKIM	17
13.	MBËSHTETJA DHE UDHËZIMET.....	17
14.	ANKESAT	17
15.	LISTA E SHTOJCAVE	17

1. HYRJE DHE KONTEKSTI I SKEMËS SË GRANTEVE

Në vitin 2023, Qeveria e ka miratuar Strategjinë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Bizneseve 2030 (SIDBS). Në analizën e situatës, dokumenti strategjik i thekson dobësitë e aftësimit profesional në industrinë e prodhimit ku tregu i punës në Kosovë karakterizohet me mospërputhje ndërmjet ofertës dhe kërkesës së fuqisë së kualifikuar punëtorë, dhe ku sistemi formal i arsimit nuk është i mjaftueshëm për t'i përgatitur punëtorët në përputhje me nevojat e industrisë prodhuese/përpunuese.

Projekti “Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë”, që financohet nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe implementohet nga LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor synon një rritje të qëndrueshme ekonomike duke e mbështetur inovacionin, gjithëpërfshirjen dhe zhvillimin social në një Kosovë më të gjelbër. Objektivi specifik i projektit synon t'i rrisë perspektivat e punësimit tek të rinjtë, veçanërisht gratë, duke e fuqizuar arsimin dhe aftësimin profesional për t'i përmbushur kërkesat e tregut të punës. Projekti synon ta mbështes dhe fuqizojë partneritetin ndërmjet sektorit privat dhe atij publik dhe ta përmirësojë cilësinë e ofertës së Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP) në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITSHME TË THIRRJES PUBLIKE

2.1. Objektivi kryesor i skemës së granteve

Objektivi kryesor i kësaj skeme të granteve të inovacionit është ta promovojë arsimin profesional dual duke i inkurajuar kompanitë e sektorit privat (punëdhënësit) të ofrojnë zgjidhje kreative për të bashkëpunuar ngushtë me IAAP-të publike (Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi Profesional), si dhe me ofruesit e akredituar të trajnimeve.¹

Bashkëpunimi ndërmjet kompanive të sektorit privat (punëdhënësve) dhe IAAP-ve publike do të bëhet përmes një konsorciumi, ku një ose më shumë kompani të sektorit privat, së bashku me një IAAP, do të zbatojnë profile të arsimit dual. Bashkëpunimi me ofruesit e akredituar të trajnimeve do të bëhet nëpërmjet kontratave për shërbime me konsorciumin që ofron kurse afatshkurtra duke u bazuar në një vlerësim të nevojave për trajnime të cilin do ta zhvillojë paraprakisht konsorciumi.

Rezultati kryesor i pritshëm i këtij aktiviteti është t'u ofrojë punëdhënësve të sektorit privat punëtorë të kualifikuar dhe përkatës në tregun e punës, duke i dhënë përparësi arsimit dual dhe balancës gjinore në AAP.

2.2. Objektivat specifike të skemës së granteve të inovacionit

Krijimi i një konsorciumi ndërmjet IAAP-ve publike dhe kompanive të sektorit privat (punëdhënësve) nëpërmjet një kontrate 12 mujore për ta mbështetur krijimin e partneriteteve ndërmjet IAAP-ve dhe kompanive në zbatimin e profileve të arsimit dual 3-vjeçar. Gjatë periudhës 12 mujore, granti mund t'i mbështesë aktivitetet e mëposhtme:

- t'i furnizojë konsorciumet me pajisje përkatëse për zbatimin e profileve të arsimit dual;
- të ofrojë materiale të domosdoshme për zhvillimin e trajnimeve të nevojshme;

¹ Ofruesit e trajnimeve të kontraktuar përmes konsorciumit duhet të jenë të akredituar ose në proces akreditimi nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Kurset jo-formale ose afatshkurtra që ofrohen nga këta ofrues të trajnimeve nuk kanë nevojë të akreditohen, edhe pse akreditimi inkurajohet shumë.

- t'i përshtat ambientet ekzistuese (punëtoritë) të partnerëve të konsorciumit, për ta lehtësuar zbatimin e arsimit dual si në ambientet e IAAP-ve publike, ashtu edhe në kompanitë e sektorit privat.

Ta mbështes arsimin joformal, rikualifikimin dhe përmirësimin e shkathtësive duke i përdorur ofruesit e akredituar të trajnimeve, duke përfshirë edhe qendrat e trajnimit në kompani:

- Arsimi dual joformal: mbështetja e institucioneve të akredituara që zbatojnë kurse afatshkurtra² duke kombinuar aftësimin në klasë dhe në vendin e punës (metodologjia e arsimit dual);
- rikualifikimi i punonjësve ekzistues në kompani të ndryshme private, mësimdhënësve dhe punëkërkesve, me qëllim që të ndihmohen punonjësit aktualë dhe të papunët të mësojnë shkathtësi të reja;
- përmirësimi i shkathtësive të fuqisë së re punëtore të diplomuar, mësimdhënësve dhe punëkërkesve me certifikim teknik sipas nevojave të tregut, duke i pajisur këto grupe të synuara me shkathtësi të përditësuara të nevojshme për tregun e punës;
- trajnimi i stafit të kompanive private për t'u bërë instruktorë në kompanisë sipas rregullores së Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) lidhur me këtë çështje.

3. STRUKTURA E SKEMËS SË GRANTEVE

Kjo skemë e granteve të inovacionit është e organizuar në dy dritare financimi me qëllim që të dallohet më mirë mbështetja që ofrohet për arsimin formal përmes profileve të arsimit dual dhe arsimit joformal përmes kurseve afatshkurtra duke e përdorur mundësisht metodologjinë e arsimit dual. Aplikacionet mund të dorëzohen për sa vijon:

1. **Dritarja 1 (e obligueshme):** Mbështetje për kompanitë private (punëdhënësit), duke i dhënë përparësi atyre që punojnë në sektorët e Eficiencës së Energjisë dhe Energjisë së Ripërtërishme, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Përpunimit të Drurit dhe Përpunimit të Ushqimit dhe Pijeve përmes një partneriteti në kuadër të një kontrate trevjeçare të konsorciumit me një institucion publik të AAP-së që zbaton profile të arsimit dual;
2. **Dritarja 2 (opsionale):** Mbështetje për kompanitë private (punëdhënësit) për të kontraktuar ofrues të akredituar të trajnimeve (përfshirë qendrat e trajnimit në kompani) që ofrojnë arsim joformal afatshkurtër (kurse afatshkurtra), përmes dorëzimit të një plani trajnimi (që duhet të bëhet brenda një periudhe 12 mujore) me ofruesit e mundshëm të trajnimeve, duke promovuar metodologjinë e arsimit dual, rikualifikimin dhe përmirësimin e shkathtësive të tyre.

3.1. Rezultatet e pritshme

Rezultatet kryesore të pritshme nga skema e granteve të inovacionit janë si më poshtë:

Sektori privat do të përfitojë me fuqi punëtore të kualifikuar në sektorët e ndryshëm me prioritet për projektin, duke i arritur objektivat e përgjithshme, ndërkohë që e promovon balancën gjinore në arsimin dual. Nga ana tjetër, do të forcohet partneriteti midis IAAP-ve publike dhe

Kurset jo-formale ose afatshkurtra që ofrohen nga këta ofrues të trajnimeve nuk kanë nevojë të akreditohen, edhe pse akreditimi inkurajohet shumë.

përfaqësuesve të sektorit privat, gjë që do të krijojë një bazë për iniciativa të qëndrueshme të arsimit dual. Partneriteti do t'i shfrytëzojë burimet dhe ekspertizën nga të dy sektorët, duke e rritur cilësinë e arsimit dhe aftësimin.

Nëpërmjet këtij programi të skemës së granteve për inovacion, priten rezultate të tjera pozitive, si p.sh., nxënësit në shkollat e AAP-së do të kenë më shumë mundësi për t'u bërë pjesë e arsimit dual, që do të thotë se ata do të kenë më shumë mundësi për të fituar njohuri praktike gjatë shkollimit. Nga ana tjetër, pritet që kjo të sjellë më shumë femra në sistemin e arsimit dual; si dhe, ato do të kenë më shumë mundësi për t'i përmirësuar shkathtësitë e tyre përmes rikualifikimit dhe përmirësimit të shkathtësive të dizajnuara enkas për to.

Pritet që të zhvillohen disa profile të reja inovative afatshkurtra të AAP-së (duke e përdorur metodologjinë e arsimit dual), të cilat do të përputhen me nevojat moderne të vendit të punës, të integruara në një kornizë të arsimit dual dhe mësimin në vendin e punës. Pritet, po ashtu, që përfaqësuesit e sektorit privat nga sektorë të ndryshëm ta njohin vlerën e arsimit dual dhe praktikave të mësimin në vendin e punës.

Këto përpjekje synojnë kryesisht që ta përmirësojnë cilësinë e fuqisë punëtore, ndërsa përfituesit do të fitojnë shkathtësi të reja dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre ekzistuese, duke i bërë ata më të përgatitur për tregun e sotëm të punës.

Parimet e skemës së granteve përfshijnë:

- ekuilibrin rajonal;
- përfshirjen gjinore;
- bashkëpunim;
- qëndrueshmërinë;
- inovacionin-qasjet inovative.

4. PËRFITUESIT E SYNUAR:

Kjo skemë e granteve të inovacionit i mirëpret aplikimet e konsorciumeve nga palët e mëposhtme.

Dritarja	Qëllimi i konsorciumeve	Konsorciumet ndërmjet
Dritarja 1	Promovimi i Arsimit Dual	• Të paktën një IAAP publik • Të paktën një kompani/biznes privat*
Dritarja 2	Promovimi i arsimit joformal, përmirësimi i shkathtësive dhe rikualifikimi duke përdorur ofrues të akredituar të trajnimeve.	

* Një konsorcium më i gjerë është i preferueshëm për të garantuar që të gjithë nxënësit që mbështeten nga profili i arsimit dual në IAAP të kenë të siguar një vend për trajnim në kompani.

5. SEKTORËT ME PRIORITET DHE OFERTAT

Skema synon **të mbështes sektorë të ndryshëm ekonomik**, duke i dhënë përparësi si më poshtë:

- Energjia e ripërtëritshme dhe eficienta e energjisë (ER/EE)
- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

- Prodhimi i ushqimit dhe pijeve
- Përpunimi i drurit

Ju lutem vini re: Kompanitë që nuk operojnë në sektorin e listuar gjithashtu mund të aplikojnë.

6. MBËSHTETJA FINANCIARE QË OFROHET NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

Buxheti maksimal në dispozicion për këtë skemë të granteve të inovacionit është **1,000,000 euro**. Aplikimet duhet të bëhen në **minimum 50,000 EUR** dhe **maksimum 100,000 EUR**.

Çdo aplikacion duhet ta ketë një rezultat/bilanc të kërkesës për sa i përket numrit të nxënësve që do të përfitojë, propozimi për t'u financuar duhet t'i ketë **të paktën 10 nxënës** që përfitojnë nga kurset e arsimit dual deri në fund të vitit të dytë të zbatimit.

Autoriteti kontraktues i kësaj skeme të granteve është Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) dhe LuxDev.

7. PRANUESHMËRIA E PËRFITUESVE TË GRANTEVE DHE KRITERET E KËRKUARA PËR KONSORCIUME DHE DORËZIMIN E PROPOZIMEVE

7.1. Kriteret e kërkuara për kompanitë/bizneset private

- duhet të jetë aktiv për të paktën një vit nga data e publikimit të thirrjes.
- kompanitë duhet të kenë ofrojnë dëshmi lidhur me hapësirën përkatëse për t'i akomoduar nxënësit e AAP-së për arsim dual.).

7.2. Kriteret e kërkuara për institucionet e AAP-së

- dëshmi të partneritetit me bizneset për të ofruar arsim dual ose mësim në vendin e punës (dokument ekzistues të nënshkruar);
- institucionet e AAP-së ofrojnë profilin për te cilin aplikojnë në formën e mësimi dual.

7.3. Kërkesat për ofruesin/ët privatë të trajnimeve

- ofrues dhe profile private të trajnimit të akredituar dhe në proces të ri-akreditimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të Kosovës (AKK).

7.4. Kërkesat e kritereve për konsorciumet

- Aplikimet duhet të përfshijnë të paktën një kompani/biznes privat dhe një IAAP publik. Preferohet një konsorcium më i gjerë;
- kur Dritarja 2 (përmirësimi i shkathtësive dhe ri-aftësimi) përfshihet në aplikim, konsorciumet duhet ta përfshijnë të paktën edhe një ofrues privat të trajnimeve;
- aplikimet vetëm për Dritaren 2 nuk kualifikohen për këtë thirrje;
- partnerët e konsorciumit duhet të kenë një marrëveshje partneriteti të nënshkruar ku përcaktohen kushtet e bashkëpunimit, rolet, kontributet financiare dhe pritjet nga secili partner;

- aplikimet duhet të udhëhiqen nga një kompani private (punëdhënëse) e cila do të udhëheqë me fazat e aplikimit dhe të ekzekutimit të projektit.

7.5. Aplikacionet që nuk mund të kualifikohen për skemën e granteve

Bizneset dhe ofruesit privatë të trajnimeve që kanë falimentuar ose janë mbyllur, që janë nën administrim gjyqësor, që i kanë pezulluar aktivitetet e biznesit ose u janë nënshtruar procedurave që ndërlidhen me këto çështje, nuk mund të marrin pjesë në thirrje ose të jenë përfitues të kësaj skeme të granteve.

Kritere shtesë të përjashtimit mund të gjenden në Shtojcën 1 - *Kriteret e përjashtimit*

7.6. Lista e dokumenteve që duhen dorëzuar

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 për Shpërndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoritë Ekonomike të Subvencioneve dhe Transfereve, subjektet që aplikojnë duhet t'i dorëzojnë dokumentet e mëposhtme përmes emailit zyrtar:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset që e kanë numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal në një certifikatë).
3. Vërtetimi tatimor me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të papaguara apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxhit.
4. Kopjen e lejes së njoftimit të personit(ve) në emrin e të cilit është regjistruar aplikuesi.
5. Dëshminë nga aplikuesi se nuk është në falimentim apo nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore/Komerciale - origjinali, jo më e vjetër se 30 ditë.
6. Dëshminë e llogarisë bankare aktive të aplikuesit në njërën nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.
7. Gjendjen e llogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit (2024). Kjo nuk do të aplikohet për aplikuesit e sapo themeluar.
8. Projekt-propozimi duke përfshirë qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare dhe planin kohor të realizimit të projektit, si dhe strukturën organizative të aplikuesit, të dhënat e të cilit janë të paraqitura në aplikacion.
9. Për ndërmarrjet e regjistruara para vitit 2024, duhet të sjellin qarkullimin për vitin 2024 dhe 2025 i dëshmuar me dokument të lëshuar nga ATK. Për ndërmarrjet e regjistruara gjatë viteve 2024 dhe 2025 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi. Ndërsa, për ndërmarrjet e regjistruara gjatë vitit 2026 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi.
10. Të mos këtë pranuar mjete nga burime të tjera financimi për të njëjtat aktivitete (kjo dëshmohet me deklaratën nën betim), e cila mund të shkarkohet në *ueb faqen* zyrtare të KIESA's të plotësohet dhe të ngarkohet për aplikim.

11. Aplikuesi i ka përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga mbështetja e mëhershme financiare, nëse kanë përfituar nga burimet e financimit publik dhe/ose nga MTI/MINT në dy vitet e fundit (kjo dëshmohet me deklaratën nën betim), e cila mund të shkarkohet në *ueb faqen* zyrtare të KIESA's të plotësohet dhe të ngarkohet për aplikim.

7.6.1. Dokumentet shtesë që kërkojnë:

Dokumentet e mëposhtme duhet të dorëzohen nga konsorciumet në kohën e aplikimit:

- Certifikata e akreditimit e lëshuar nga AKK me vlefshmëri në kohën e aplikimit (me përjashtim të IAAP-ve publike të menaxhuara nga Komunitat dhe Qendrave të Kompetencës (QK) të menaxhuara nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr)). Në rast se një ofrues i trajnimeve është në proces të ri-akreditimit, do të mjaftojë një letër kërkesë për ri-akreditim me vulën e AKK-së që konfirmon pranimin e kërkesës.
- Marrëveshja e nënshkruar e partneritetit ndërmjet anëtarëve të konsorciumit me role, përgjegjësi, financim dhe marrëveshje të tjera të qarta varësisht nga projekt-propozimi.

7.7. Kërkesat dhe sqarimet për dorëzimin e propozimit

- Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- Të gjithë nxënësit që përfitojnë nga një profil i arsimit dual që mbështetet nga projekti duhet ta kenë një pozitë të siguruar në një kompani private për komponentin e trajnimit në kompani.
- Të gjithë nxënësve duhet t'u ofrohet një kompensim (100% i mbuluar nga kompanitë private në kuadër të buxhetit të bashkëfinancimit sipas rregullave të Ministrisë së Arsimit) dhe kostot e sigurimit që ofrohen nga kompanitë private, respektivisht komunitat. Në rast të marrëveshjes së ndërsjellë, sektori privat mund t'i mbulojë edhe kostot e sigurimit, me kusht që të përmendet në buxhetin e bashkë-financimit.
- Pajisjet që kërkojnë të subvencionohen duhet të jenë të reja dhe të jenë të dëshmuara me markën e Konformitetit Evropian (CE).
- Përfituesi nuk ka të drejtë të shesë asnjë pajisje të blerë përmes këtij granti brenda tre viteve nga data e nënshkrimit të kontratës së grantit. Kjo klauzolë do të jetë pjesë përbërëse e marrëveshjes së grantit.
- Në rast të ndonjë kostoje të paparashikuar në lidhje me implementimin e projekt propozimit, përfituesi do të jetë përgjegjës për mbulimin e këtyre shpenzimeve, nëse implementimi i projektit bëhet me kosto më të ulët atëherë kompania përfituese obligohet të kthejë diferencën e mjeteve sipas përqindjes së grantit.
- Në rast të përfitimit nga granti, nuk lejohet ndryshimi i idesë fillestare baze siç përshkruhet në projekt propozim gjatë fazës së implementimit të projektit.
- Çdo aktivitet tjetër që nuk është në përputhje me këtë thirrje publike nuk do të pranohet.
- Aplikuesi duhet të paraqesë pjesëmarrjen e financimit të tij (minimum 10% e buxhetit) në pjesën e buxhetit të aplikacionit.
- Para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, përfituesi është i obliguar që ta hapë një llogari të re bankare ose nën llogari të dedikuar për ta administruar grantin.
- Para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, kompania udhëheqëse që aplikon obligohet që ta sjellë garancionin valid bankar të lëshuar nga një institucion financiar të regjistruar, të

licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), për vlerën totale të grantit deri në përfundim të projektit

- Pasi që kjo skemë ka për qëllim të promovojë dhe zhvillojë arsimin dual dhe është financim i drejtpërdrejtë nga Qeveria e Luksemburgut, atëherë të drejtë aplikimi kanë të gjitha ndërmarrjet pavarësisht nga skemat tjera të KIESA's.
- Ndërmarrjet të cilave iu ka skaduar afati i marrëveshjeve nga skemat paraprahe të KIESA's dhe që nuk i kanë përmbushur obligimet e atyre skemave, nuk kanë të drejtë përfitimi nga kjo skemë.
- Nëse kompania është përfituese, atëherë do të nënshkruhet një marrëveshje, pjesë e të cilës do të jenë edhe deklaratat e bëra gjatë aplikimit.
- TVSH-ja është një shpenzim i pranueshëm për personat fizikë dhe ndërmarrjet që nuk e deklarojnë TVSH-në, ndërsa për ndërmarrjet që e deklarojnë TVSH-në, ky është një shpenzim i papranueshëm.
- Lista e ndërmarrjeve të vlerësuara do të publikohet në ueb-faqen e MINTI/KIESA. Varësisht nga limitet buxhetore, lista e bizneseve përfituese mund të parasheh deri në pesë (5) biznese rezervë. Në rast të tërheqjes apo dështimit të ndonjë biznesi përfitues, atëherë ai mund të zëvendësohet me bizneset sipas listës rezerve.
- Skema e granteve synon t'i mbështes drejtpërdrejt bizneset dhe e inkurajon ngritjen e kapaciteteve profesionale përbrenda kompanive. Prandaj, kompanitë konsulente që ofrojnë shërbime për bizneset aplikuese përjashtohen nga ky proces me këtë thirrje. Në rast të identifikimit të përfshirjes së tyre si përfaqësues të bizneseve, aplikuesit do të diskualifikohen. Kjo për shkak se i tërë procesi është i thjeshtë dhe pa kosto financiare, duke filluar nga metoda e aplikimit elektronik përmes emailit zyrtar, deri te vlerësimi, nënshkrimi i marrëveshjeve, shpërndarja e fondeve dhe monitorimi i tyre.

Shënim i rëndësishëm:

Në rast të mos-përmbushjes së kriterëve, formulari i aplikimit do të konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

8. AFATET DHE KUSHTET

8.1. Shpenzimet e pranueshme

Dritarja 1 – Konsorciumet midis sektorit privat dhe IAAP-ve publike që ndërlidhen me arsimin dual dhe mësimin në vendin e punës

- A.** Blerja e pajisjeve, veglave dhe modeleve të nevojshme për zbatimin e arsimit dual, përfshirë edhe koston e instalimit.
(p.sh. vegla dhe pajisje të specializuara që kërkohen nga fusha e studimit, siç janë makinat CNC të vogla ose edukative për prodhim, prodhim shtesë (printerë 3D dhe softuerë), kompjuterë dhe pajisje të tjera të TIK-ut, modele trajnimi duke përfshirë maketa ose simulatorë/sete për zhvillim softuerësh për TI).
- *Shuma maksimale - pjesa e buxhetit total: 60%*
- B.** Lënda e parë, material shpenzues, furnizime për zyrë dhe materiale të tjera për zbatimin e arsimit dual.

(p.sh., panele druri, gozhda dhe vida, kablllo eterneti, terminale elektrike për instalime elektrike ose çdo material tjetër që konsumohet pjesërisht ose tërësisht gjatë trajnimit.) Stilolapsa, letër, fletore dhe dosje dhe furnizime të tjera për zyrë që përdoren për ta mbështetur trajnimin).

- *Shuma maksimale - pjesa e buxhetit total: 30%*

C. Përshtatja/rregullimi i sallave të trajnimit dhe punëtorive.

(p.sh. karrige, tavolina dhe ulëse fleksibile të përshtatura për punëtori, ndarje e hapësirave për aktivitete të ndryshme, lidhje interneti, instalime elektrike të përshtatura për pajisje të reja, pajisje sigurie, përmirësime në ndriçim dhe ventilim).

- *Shuma maksimale - pjesa e buxhetit total: 40%*

D. Shpenzimet e transportit për nxënësit që ndjekin arsimin dual

- *Shuma maksimale - pjesa e buxhetit total: 20%*

E. Promovimi i qasjes së arsimit dual dhe rezultatet

(p.sh. zhvillimi i një strategjie për marrëdhënie me publikun për ngritjen e vetëdijesimit lidhur me arsimin dual)

- *Shuma maksimale - pjesa e buxhetit total: 5%*

F. Shpenzimet e mirëmbajtjes për pajisjet dhe makineritë e e siguruar nga skema e granteve.

(p.sh. mirëmbajtja e rregullt, inspektimet e planifikuara, riparimet dhe ndërrimet e pjesëve rezervë, etj.)

- *Shuma maksimale - pjesa e buxhetit total: 20%*

*Një shembull: Nëse buxheti total i projekt-propozimit është 50,000 EUR, kostoja maksimale për blerjen e pajisjeve/modeleve/materialeve nuk mund të kalojë 30,000 EUR (50,000 EUR *60%). E njëjta gjë vlen edhe për artikujt e tjerë me përqindje maksimale të përcaktuar (%).*

Dritarja 2 - Mbështetje për ofruesit e akredituar të trajnimeve të sektorit privat, duke përfshirë qendrat në kompani për ta përmirësuar arsimin dual, rikualifikimin dhe përmirësimin e shkathtësive.

A. Trajnime - Rikualifikim dhe përmirësim i shkathtësive të mësimdhënësve, instruktorëve në kompani dhe stafit tjetër teknik të kompanive përmes ofruesve privatë të trajnimeve dhe Qendrave të Aftësisit Profesional (QAP).

(objektivi i rikualifikimit dhe përmirësimit të shkathtësive është që t'u ofrohen mësimdhënësve dhe profesionistëve të industrisë shkathtësitë e nevojshme për t'u përshtatur me mjedisin arsimor dhe të industrisë në ndryshim.

B. Zhvillimi i materialeve të trajnimit për zbatimin e rikualifikimit/përmirësimin e shkathtësive dhe përkthimin e materialeve

C. (p.sh. zhvillimi i materialeve të trajnimit përmes vlerësimit të nevojave, identifikimit të boshllëqeve në shkathtësi). Mbështetje për përditësimin dhe zhvillimin e kurrikulave për trajnime afatshkurtra

(p.sh. përditësimi dhe zhvillimi i kurrikulave për trajnime afatshkurtra është thelbësor për të siguruar që programet të mbeten relevante dhe efektive, me qëllim të përmbushjes së nevojave të nxënësve, si dhe të industrive).

- D.** Trajnimi i instruktorëve në kompani dhe trajnimi i mësimdhënësve të praktikës profesionale: trajnime pedagogjike dhe teknike (p.sh. të kuptuarit e teorive të të nxënit, parimeve të të nxënit për të rritur, zhvillimit të kurrikulave, teknikave të vlerësimit, menaxhimit të klasës, etj.)

8.2. Shpenzimet e pa pranueshme

1. Kompensimi dhe sigurimi për praktikantët (edhe pse ky artikull nuk është i pranueshëm, ky shpenzim duhet të merret përsipër nga kompanitë e sektorit privat dhe duhet të jetë i pranishëm në buxhetin e bashkë-financimit, dhe do të jetë po ashtu një artikull i obligueshëm në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit);
2. Pagat e punonjësve ekzistues ose atyre të rinj.
3. Ndërtimi i objekteve/lokaleve.
4. Zhvillimi i kurrikulave të reja formale për aftësim në AAP.
5. Pajisjet/mjetet që nuk ndërlidhen me kurset ekzistuese të trajnimit.
6. Shpenzimet e transportit për mësimdhënësit, ose instruktorët në kompani dhe punonjësit që kanë të bëjnë me zbatimin e projektit.
7. Shpenzimet e amortizimit dhe zhvlerësimit e pajisjeve dhe makinerive të përdorura për trajnim praktik gjatë zbatimit të projektit.

8.3. Pranimi/pranueshmëria e shpenzimeve

Shpenzim i pranueshëm është vetëm kostoja e shpenzimeve të realizuara, të vërtetuara me fatura të rregullta dhe transaksione bankare, duke përfshirë pagesat përmes kartave bankare. Të gjitha shpenzimet duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga kjo thirrje e skemës së granteve të inovacionit. Vetëm "shpenzimet e pranueshme" mund të merren parasysh për sa i përket grantit. Kostot e pranueshme duhet të bazohen në shpenzimet aktuale të parapara në projekt propozim dhe dokumentet mbështetëse. Në rast të ndonjë përpjekje mashtrimi (p.sh. falsifikimi i faturave, tentativa e qëllimshme për keqpërdorim të fondeve), Autoriteti Kontraktues e rezervon të drejtën ta ndalojë këstin e pagesës dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për kthim të mjeteve përkatëse kundër kompanisë përfituese të përfshirë në mashtrim. Është në interesin e aplikuesit që ta dorëzojë një buxhet real dhe me kosto efektive.

Pajisjet/veglat e blera duhet të jenë të reja dhe ta kenë shenjë CE.

8.4. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e projektit të financuar nga Qeveria e Luksemburgut është 12 muaj.

8.5. Bashkë-financimi

Konsorciumet e kontraktuara duhet të ofrojnë të paktën 10% bashkëfinancim për projektin e propozuar. Ky bashkë-financim nuk mund të jetë kontribut në natyrë dhe duhet të paraqitet si shpenzim në buxhetin e propozuar. Bashkë-financimi duhet të bëhet para muajit 12 të zbatimit të projektit.

8.6. Kushtet e pagesës duke përfshirë bashkë-financimin

Pagesa për kontratat e dhëna do të ndjekë planin e pagesave të specifikuar më poshtë:

Fokusi i aplikimit	% e shumës totale	Kushti për pagesë
Pagesa avans	70%	Garancioni bankar prej 100% të vlerës totale të grantit.
Kësti i fundit	30%	- Raporti financiar ku detajohen të paktën 80% e shpenzimeve të paradhënies me tërë dokumentacionin ligjor të miratuar nga Komisioni i monitorimit dhe nga LuxDev. - Realizimi i Planit të Synimeve siç është rënë dakord në marrëveshjen e nënshkruar të grantit dhe dorëzimi i raportit të progresit, si dhe miratimi nga Autoriteti Kontraktues.

Pagesa e parë e quajtur "Paradhënie" do të paguhet pas nënshkrimit të kontratës së grantit nga të gjitha palët me garancinë bankare të ofruar për shumën totale të kontratës.

Kësti i fundit duhet të paguhet jo më vonë se 12 muaj pas nënshkrimit të kontratës.

9. QEVERISJA DHE MBIKËQYRJA E SKEMËS

Kjo thirrje për skemën e granteve të inovacionit është zhvilluar dhe miratuar nga Komisioni i skemës së granteve, që përbëhet nga përfaqësues të MASHTI-t, MINT, dhe anëtarët e ekipit LuxDev të projektit “Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë”.

Rolet dhe përgjegjësitë e secilit partner janë të përshkruara në tabelën më poshtë.

Institucioni	Rolet dhe përgjegjësitë
Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) / Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Autoriteti kontraktues dhe mbikëqyrja e skemës së granteve të inovacionit; Organizimi dhe pjesëmarrja në Komisionin vlerësues; Emërimi i Komisionit të monitorimit Komunikimi me email zyrtar.
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	Vlerësimi dhe mbikëqyrja e kurrikulave për arsimin dual; Zbatimi i profileve të arsimit dual përmes IAAP-ve.
Oda Ekonomike e Kosovës	Vlerësimi dhe mbikëqyrja e instruktorëve në kompani. Komunikimi dhe shtrirja e aktiviteteve për arsimin dual. Kontrolli i cilësisë së instruktorëve në kompani.

	Emërimi i ekspertëve për Komisionin vlerësues (specifik për sektorë).
LuxDev	Validimi dhe pjesëmarrja në Komisionin vlerësues; Pjesëmarrja në Komisionin e monitorimit; Mbështetja financiare dhe administrative.

10. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Përfituesit do të duhet t'ia dorëzojnë rregullisht autoritetit zbatues raportet e radhitura më poshtë.

Lloji i raportit	Shpeshtësia
Raporti i zbatimit të projektit, duke përfshirë raportet financiare	Çdo vit
Raportet e monitorimit dhe vlerësimit, raportimi mbi rezultatet: a) numri i nxënësve të përfshirë në arsim dual dhe mësim në vendin e punës. b) numri i përfituesve në arsimin jo-formal, rikualifikim dhe përmirësim të shkathtësive. Të gjitha të dhënat duhet të ndahen sipas gjinisë dhe grupeve të tjera të cënueshme, siç janë pakicat etnike, nxënësit nga familjet përfituese të ndihmës sociale, personat me aftësi të kufizuara, etj.	3 muaj
Raporti final i përgatitur nga përfituesi i cili përmban: - Një përshkrim të shkurtër të aktiviteteve të projektit - Raporti i plotë financiar - Objektivat e arritura dhe mësimet e nxjerra	Fundi i projektit.

10.1. Monitorimi dhe Komisioni i monitorimit

Monitorimi i projekteve fituese do të bëhet nga një Komision i monitorimit i emëruar nga KIESA/MINTI dhe i mbështetur nga LuxDev, i cili do të përfshijë përfaqësues nga projekti LuxDev, KIESA/MINTI, MASHTI dhe OEK.

Komisioni i monitorimit është i obliguar ta përgatis një raport përmbledhës mbi zbatimin e projekteve çdo katër muaj. Komisioni do t'i emërojë, nga përbërja e tij, të paktën dy përfaqësues për të dalë në terren dhe për të kryer vizita monitorimi.

Komisioni i monitorimit dhe përfituesit e projektit janë të obliguar t'ia ofrojnë LuxDev-it tërë dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që të kryhen të gjitha kontrollet, përputhshmëritë dhe auditimet përkatëse.

Komisioni i monitorimit do të jetë përgjegjës për të kontrolluar nëse grantet janë në përputhje me objektivat fillestare dhe nëse haset ndonjë parregullsi, komisioni i monitorimit do t'i raportojë KIESA/MINT-it dhe LuxDev-it, të cilët, më pastaj, do të vendosin për ekzekutimin e garancive të ofruara dhe do të sigurojnë rimbursimin e fondeve.

Komisioni i monitorimit do të jetë përgjegjës për të kryer kontrolle të dokumentacionit të shpenzimeve të kompanive në bazë të raportit financiar të dorëzuar me kërkesën për këstin e fundit dhe në përmbyllje të projektit. Në çdo moment gjatë zbatimit të projektit, LuxDev mund të kryejë auditime dhe kontrolle të brendshme të dokumentacionit të projektit.

Është përgjegjësi e OEK-ut, bazuar në mandatin e saj dhe si pjesë e komisionit të monitorimit që ta monitorojë zbatimin e arsimit dual brenda kompanive. Anëtarët e konsorciumit duhet të ofrojnë një mjedis të përshtatshëm mësimi për arsim dual dhe të gjitha kompanitë duhet të kenë trajnerë të trajnuar në kompani sipas standardeve të përcaktuara nga OEK-u.

Qasja rajonale nëpërmjet zyrave rajonale të OEK-ut do të përdoret gjatë monitorimit të zbatimit të projektit, në mënyrë që të sigurohet një mbikëqyrje më e mirë e projektit. Zyrat rajonale të OEK-ut do ta lehtësojnë ndërlidhjen me kompanitë dhe do të ndihmojnë në komunikim midis zyrës qendrore të OEK-ut dhe komisionit të monitorimit.

LuxDev do ta mbikëqyrë progresin e skemës së granteve dhe rezultatet e saj, afatet kohore dhe kufizimet gjatë takimit të këshillit drejtues që do të mbahet një herë në vit, dhe do t'i përcaktojë veprimet në Planin Operativ Vjetor të projektit.

Komisioni i monitorimit do t'i vazhdojë aktivitetet e monitorimit edhe pas implementimit 12-mujor të grantit përgjatë periudhës 3-vjeçare të zbatimit të profilit të arsimit dual. Pas zbatimit të grantit, komisioni i monitorimit do ta monitorojë çdo vit progresin e nxënësve që janë mbështetur nga programi i granteve.

KIESA/MINT mund ta zëvendësojë përfaqësuesin nga LuxDev në rast të vazhdimit të projektit ose të një projekti të ri në mbështetje të arsimit dhe aftësisht profesional.

10.2. Mbyllja e projektit

Përfutyesi është i obliguar t'ia dorëzojë komisionit të monitorimit një raport përmbyllës i cili do të përmbajë një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve dhe një raport të plotë financiar të të gjitha shpenzimeve të projektit, duke përfshirë dokumentet e mbetura financiare nga kësti i fundit si dhe pjesën e mbetur të kështit të parë të pashpenzuar para dorëzimit të pagesës për kështin e dytë.

Projekti do të konsiderohet i mbyllur dhe i finalizuar vetëm pas miratimit të raportit përfundimtar nga komisioni i monitorimit dhe nga LuxDev (pas kontrolleve përfundimtare financiare). Nëse komisioni i monitorimit dhe/ose LuxDev gjejnë ndonjë parregullsi gjatë këtij kontrolli përfundimtar, mund të merren masa lidhur me garancinë bankare të ofruar.

11. PROCESI I VLERËSIMIT DHE KRITERET PËR VLERËSIMIN

11.1. Procesi i vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga **minimum pesë anëtarë** (shih seksionin tjetër). Ky proces autonom do të realizohet në dy faza, që do të plotësohet në një seancë vlerësimi.

Në fazën e parë, komisioni i vlerësimit do të përcaktojë nëse aplikacionet i kanë përmbushur kërkesat administrative të përcaktuara në këtë Manual Operativ, nëse aplikuesit nuk i nënshtrohen ndonjë prej kriterëve të përjashtimit siç detajohet në Shtojcën I të këtij manuali dhe nëse i tërë dokumentacioni i nevojshëm është dorëzuar plotësisht. Vetëm aplikacionet që e kalojnë këtë fazë do të vlerësohen.

Në fazën e dytë, aplikacionet që janë miratuar për vlerësim nga faza e parë, do të vlerësohen bazuar në kriteret e përshkruara në seksionin më poshtë Kriteret për vlerësim dhe formulari i vlerësimit

(paragrafi 11.3). Anëtarët e komisionit do t'i vlerësojnë dhe poentojnë bashkërisht aplikacionet përmes një diskutimi të përbashkët (paragrafi 11.3).

11.2. Komisioni vlerësues

Komisioni vlerësues do të përbëhet nga pesë anëtarë. Edhe pse secila palë do t'i emërojë anëtarët e saj, MINT/KIESA dhe LuxDev duhet ta arrijnë një konsensus lidhur me anëtarët e emëruar.

1. Një anëtar do të jetë nga stafi i KIESA/MINTI i cili emërohet nga drejtori i KIESA-s.
2. Një anëtar do të jetë ekspert i brendshëm i LuxDev i emëruar nga LuxDev.
3. Një anëtar do të jetë nga stafi i departamentit të AAP-së në MASHTI.
4. Një anëtar do të jetë nga stafi i OEK i cili emërohet nga drejtori i OEK.
5. Nëse është e mundur, anëtari i fundit do të jetë një ekspert nga sektori privat i përzgjedhur bashkërisht nga KIESA/MINTI dhe LuxDev, apo te angazhohet një zyrtar brenda MINTI.

Aplikacionet do të vlerësohen nga një komision vlerësues i themeluar nga KIESA. Për të qenë teknikisht në përputhje, aplikacionet duhet të marrin të paktën 51 pikë nga 100 pikë pas llogaritjeve për të dyja Dritaren 1 dhe Dritaren 2. Kriteret për vlerësimin e skemës së granteve të Dritares 1 dhe Dritares 2 janë përshkruar më poshtë.

Poenët nga vlerësimi do të llogariten duke e përdorur mesataren e thjeshtë të poenëve të Dritares 1 dhe Dritares 2. Nëse një propozim është vetëm për Dritaren 1, poenët e përgjithshëm për Dritaren 1 do të jenë poenët përfundimtar të propozimit.

11.3. Kriteret e vlerësimit të aplikacioneve për Dritaren 1

Kriteret e vlerësimit	Pikët
Kriteret A - Përputhja strategjike me ofertën e propozuar të trajnimit	20
A.1 Përputhja e investimeve me planifikimin e ofertës së trajnimit	15
A.2. Zhvillimi i sektorëve që konsiderohen me prioritet	5
Kriteret B - Përshtatshmëria e kompetencave të qendrës dhe kapacitetet e brendshme për zbatim	15
B.1. Kapacitetet e brendshme për zbatim	10
B.2. Kapaciteti teknik i instaluar	5
Kriteret C - Përgjigjja ndaj nevojave të sektorit privat	25
C.1. Kontributi i propozimit në zhvillimin e sektorit privat dhe profileve të arsimit dual konsiderohet strategjik për zhvillimin socio-ekonomik të vendit.	25
Kriteret D - Cilësia e projektit	30
D.1. Inovacioni - Trajnimi pedagogjik dhe metodologjik	10

D.2. Inovacioni teknologjik	10
D.3. Modernizimi i hapësirave të trajnimit	10
Kriteret E - Grupet prioritare	10
E.1. Grupet prioritare	10
Maksimumi i pikëve të përgjithshme	100

11.4. Kriteret shtesë të vlerësimit për Dritaren 2

Kriteret e vlerësimit	Pikët
Kriteret A - Përshtatja strategjike	25
A.1. Zhvillimi i sektorëve që konsiderohen me prioritet	10
A.2. Zhvillimi i kompetencave përmes shkathtësive transversale	15
Kriteret B - Cilësia e trajnimit të propozuar	35
B.1. Inovacioni	15
B 2. Kontributi i propozimit në zhvillimin e sektorit privat	20
Kriteret C - Potenciali për punësim	40
C.1. Punësimi	40
Maksimumi i pikëve të përgjithshme	100

12. PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE AFATI KOHOR

12.1. Procedurat e aplikimit

- Aplikimi bëhet përmes emailit zyrtar arsimidual@rks-gov.net
- Njoftimi i thirrjes publike është shpallur në ueb-faqen e MINT dhe KIESA:
 - <https://mint.rks-gov.net>
 - <http://kiesa.rks-gov.net>
- Përfitues do të jenë aplikacionet që janë renditur me pikët më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht nga kufizimet buxhetore të planifikuara.
- Lista e bizneseve përfituese do të publikohet në ueb-faqen e cekur më lartë.

12.2. AFATI PËR APLIKIM

Afati i fundit për aplikim është deri më date 30.04.2026 në 23:59h dhe aplikacionet pas kësaj ore nuk pranohen.

Komisioni i vlerësimit i KIESA/MINTI, sipas afateve të parapara në UA 01/2018 do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve dhe do të vendosë nëse aplikuesit i plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MTI 01/2018) dhe kriteret shtesë të përcaktuara në thirrjen publike, në mënyrë që të kualifikohen për mbështetje financiare.

13. MBËSHTETJA DHE UDHËZIMET

Informatat dhe sqarimet shtesë mund të merren përmes e-mailit në adresën: sme.kiesa@rks-gov.net në përputhje me UA (MTI) Nr. 01/2018, por jo më vonë se pese (5) ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.

14. ANKESAT

Pas publikimit të rezultateve preliminare, aplikuesit të cilët nuk janë shpallur përfitues të kësaj skeme të granteve mund t'i drejtojnë ankesat përmes emailit arsimidual@rks-gov.net brenda tetë (8) ditëve të punës nga data e shpalljes së rezultateve preliminare.

Shënim i rëndësishëm:

- Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim brenda 8 ditë pune nga data e shpalljes së rezultateve preliminare dhe duhet të përfshijnë të gjithë dokumentacionin përkatës që e mbështet ankesën.
- Komisioni i ankesave do t'i shqyrtojë të gjitha ankesat në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MTI 01/2018).
- Komisioni i ankesave do t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe do të përgjigjet palëve ankimore sipas UA 01/2018.

15. LISTA E SHTOJCAVE

Ftohen aplikuesit që t'i plotësojnë dokumentet si në vijim:

Shtojca I Kriteret e përjashtimit

Shtojca II Deklarata nën betim e aplikuesit.

Shtojca III Formulari i aplikimit

Shtojca IV Formulari i aplikimit për buxhet

Shtojca I:

Kriteret e përjashtimit

Lista e kriterëve minimale për përjashtim nga financimi sipas kësaj marrëveshjeje aplikohen nëse:

- Përfituesit e fondeve ose personat me fuqi përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli brenda organizatës së tyre përkatëse kanë qenë objekt i një gjykimi ose vendimi administrativ të formës së prerë për:
 - Pjesëmarrje në ndonjë organizatë kriminale,
 - Korrupsion,
 - mashtrim,
 - Vepra penale të terrorizmit ose vepra penale që ndërlidhen me aktivitete terroriste,
 - Shpëlarje të parave ose financim të terrorizmit,
 - Shkelje të drejtave të njeriut, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, shfrytëzimin e punës së fëmijëve dhe format e tjera të trafikimit të qenieve njerëzore,
 - Procedurat e falimentimit, paaftësisë paguese ose likuidimit (nëse aplikohet),
 - Krijimi i një subjekti nën juridiksion tjetër me qëllim të shmangies së detyrimeve fiskale, sociale ose detyrimeve të tjera ligjore të zbatueshme në juridiksionin e zyrës së tij të regjistruar, administratës qendrore ose selisë së biznesit.
- Nëse MINT/KIESA dhe LuxDev e kuptojnë se ndonjë përfitues i fondeve ose personat me kompetenca përfaqësimi, vendimmarrje ose kontrolli brenda organizatës së tyre kanë qenë fajtorë për shkelje të rëndë të punës profesionale ose për keqinterpretim në dhënien e informatave të kërkuara lidhur me pjesëmarrjen e tyre në marrëveshje ose nuk kanë arritur të ofrojnë informata të tilla.

Për më tepër, palët do të ndërmarrin masa të arsyeshme, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e tyre, për të siguruar që kandidatët ose ofertuesit e mundshëm dhe aplikuesit të përjashtohen nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi ose dhënien e granteve, nëse njëra nga palët është në dijeni se subjektet ose personat e tillë me kompetencë përfaqësimi, vendim-marrje ose kontrolli mbi ta kanë qenë objekt i një gjykimi ose vendimi administrativ përfundimtar për arsyet e cituara më lartë.

Këto kriterë do të mbulohen nëpërmjet një deklarate nën betim që do të kërkohet nga aplikuesit:

Shtojca III

FORMULARI I APLIKIMIT

Skema e granteve të inovacionit për promovimin dhe zbatimin e arsimit dual të AAP

Nxitja e arsimit dual nëpërmjet promovimit të konsorciumeve ndërmjet institucioneve publike të AAP-së dhe kompanive të sektorit privat.

Hyrje

Një vegël për nxitjen e arsimit dual në Kosovë.

LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor, përmes projektit “Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë”, synon ta ri-formësojë arsimin aktual përmes promovimit të arsimit dual për të krijuar mundësi reale punësimi për të rinjtë në Kosovë. Qëllimi i përgjithshëm është që t’i lidhë nxënësit me vende reale të punës, veçanërisht duke i ndihmuar të rinjtë dhe femrat t’i ndërtojnë karrierat e tyre duke i përputhur shkathtësitë e tyre me nevojat e sektorit privat - bizneset aktive në sektorët e Energjisë së Ripërtërishme dhe Eficiencës së Energjisë (ER/EE), Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Prodhimit (të gjitha llojet e prodhimit të produkteve). Kompani të ndryshme të përfshira në sektorët e lartpërmendur po kanë vështirësi në gjetjen e punëtorëve me shkathtësi të duhura, dhe kjo skemë e granteve pritet që të ndihmojë në zgjidhjen e këtij problemi. Kjo iniciativë do t’i fuqizojë nxënësit e IAAP-ve publike me shkathtësi reale pune, duke rritur punësimin e tyre dhe duke i përmbushur kërkesat e tregut të punës.

Objektivi

Objektivi kryesor i programit të skemës së granteve është që ta promovojë arsimin dual të AAP-së duke i bërë bashkë bizneset dhe shkollat profesionale - si publike ashtu edhe ato private. Ideja e përgjithshme është që të krijohen partneritete përmes konsorciumeve që do t’i mbështesin nxënësit e IAAP-ve që të përfshihen në mjedise reale pune, duke ndjekur modelin e dëshmuar të arsimit dual.

Skema e granteve pritet që t’i ndihmojë kompanitë aktive në sektorët e përzgjedhur të gjejnë punëtorë të kualifikuar, me theks në rritjen e numrit të femrave që kanë qasje në trajnime profesionale dhe në përvojë pune. Për ta bërë këtë, pritet që IAAP-të të krijojnë partneritete përmes konsorciumeve me bizneset lokale nëpërmjet një marrëveshje partneriteti tre-vjeçare. Projekti i financuar nga skema e granteve do t’u ofrojë konsorciumeve të themeluara mjetet dhe pajisjet e nevojshme për të ofruar trajnim praktik të cilësisë së lartë që do t’i përgatis nxënësit në përputhje me kërkesat reale të tregut.

Kush mund të aplikojë për skemën e granteve?

Aplikuesit duhet të përbëhen nga bizneset lokale nga sektori privat që janë të angazhuara në sektorët prioritarë të lartpërmendur si pjesë e një konsorciumi me IAAP-të publike dhe private për një kohëzgjatje prej tre vitesh.

Vlera monetare e granteve të ofruara me skemën e granteve

Shuma totale e skemës së granteve është 1,000,000 EUR, nga e cila pritet të përfitojnë të paktën 10 konsorciume në kuadër të skemës së granteve. Aplikimet duhet të jenë ndërmjet 50,000 EUR dhe 100,000 EUR. Kontributi maksimal nga projekti pritet të jetë 80-90% e kostos totale të projektit, sipas formularit të buxhetit në Shtojcën IV, ndërsa kontributi nga konsorciumi pritet të jetë 10-20% e vlerës totale të projektit.

Nga një grant pritet që të ndahet në secilin prej shtatë rajoneve administrative të Republikës së Kosovës.

Çdo aplikacion duhet ta ketë një rezultat/bilanc të kërkesës për sa i përket numrit të nxënësve që do të përfitojë; propozimi për t’u financuar duhet t’i ketë **të paktën 10 nxënës** që përfitojnë nga kurset e arsimit dual deri në fund të vitit të dytë të zbatimit.

Autoriteti kontraktues dhe zbatues i kësaj skeme të granteve është Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).

Buxheti i kërkuar për projekt propozimin

Dritarja 1

Përshkrimi	Vlera totale
Kontributi i konzorciumit	
Kërkesa për përkrahje	
Buxheti total i projekt propozimit	

Dritarja 2

Përshkrimi	Vlera totale
Kontributi i konzorciumit	
Kërkesa për përkrahje	
Buxheti total i projekt propozimit	

Aplikimi dhe afati kohor

Aplikacionet duhet të dorëzohen në KIESA përmes emailit zyrtar sipas afatit të aplikimit të shpallur nga KIESA përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit.

Vlerësimi i propozimeve

Komisioni teknik i KIESA-s do t'i vlerësojë aplikacionet. Ky komision do të vendos. Rezultatet e skemës së granteve do të shpallen nëpërmjet publikimit të rezultateve nga KIESA/MINTI.

Kriteret për dorëzimin e aplikacioneve

Formulari i aplikimit mund të dorëzohet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Kriteret e hollësishme mund të gjenden duke e shkarkuar dokumentin: Korniza e granteve për arsimin dual në linkun e mëposhtëm:

Informata të mëtejshme

Informatat se si të plotësohet formulari i aplikimit është dhënë në secilin seksion. Nëse nevojiten sqarime të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni personin përgjegjës në KIESA në adresën e mëposhtme të email-it: sme.kiesa@rks-gov.net

FORMULARI I APLIKIMIT

Seksioni 1: Të dhënat e aplikantit (vlen për dritaren 1 dhe dritaren 2)

Emri i konsorciumit:
Adresa e emailit:
Numri i telefonit:
Emri i organizatës udhëheqëse (Partner nga sektori privat):
Emri i IAAP-së:
Personi kontaktues:
Adresa e aplikantit udhëheqës:

Dritarja 1

Seksioni 2: Përmbledhja e projektit

Titulli i projektit:
Emri i profilit që zbatohet në arsimin dual:
Qellimi i projektit:
Aktivitetet e projektit:
Objektivat dhe rezultatet e pritshme: (Ofroni një përmbledhje koncize të projektit, objektivave dhe rezultateve të tij)
Kohëzgjatja dhe plani kohor i realizimit të projektit:
Kostoja totale financiare e projektit:

Totali i financimit që është kërkuar:
Numri total i përfituesve: (Numri i nxënësve në arsimin formal të AAP-së dhe arsimin jo-formal të AAP-së).
Arsyeshmëria e projektit: (Ofroni një përshkrim të shkurtër se si projekt-propozimi do t'i plotësojë boshllëqet e shkathtësive në sektor)
Struktura organizative e biznesit: (përshkrimi i organogramit të biznesit privat)

Seksioni 3: Të dhënat e konsorciumit

Listoni të gjithë anëtarët e konsorciumit (kompanitë pjesëmarrëse): • <i>Anëtari 1: Emri, organizata</i> • <i>Anëtari 2: Emri, organizata</i>
Natyra e partneritetit: (Përshkruani se si sektori privat dhe IAAP-të do të bashkëpunojnë për ta zbatuar arsimin dual)
Rolet dhe përgjegjësitë (referojuni rregullores ekzistuese mbi arsimin dual në Kosovë): <i>Partneri nga sektori privat:</i> • Roli 1 • Roli 2 <i>Institucioni publik i AAP-së:</i> • Roli 1 • Roli 2

Seksioni 4: Aktivitetet kryesore të projektit

Aktivitetet kyçe: • Aktiviteti 1 • Aktiviteti 2
Rezultatet e pritshme të trajnimit:

Seksioni 5: Buxheti (referojuni formularit të buxhetit të bashkëngjitur në Shtojcën IV)

Seksioni 6: Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi dhe Vlerësimi: (Përshkruani se si do ta matni suksesin e projektit tuaj)

Seksioni 7: Informatat shtesë

- Kopjet e të gjitha marrëveshjeve ndërmjet IAAP-ve dhe partnerëve të konsorciumit
- CV-të e menaxherëve të konsorciumeve dhe instruktorëve në kompani
- Çfarëdo dokumenti mbështetës shtesë

Dritarja 2

(nga ky seksion e tutje aplikimi ndërlidhet me dritaren 2)

Seksioni 8: Përmbledhje e nevojave për trajnim

Një përshkrim i shkurtër i aktivitetit biznesor të konsorciumeve - Cili është fokusi kryesor i kompanive në konsorciume, çfarë prodhojnë ato?
Identifikimi i boshllëqeve të shkathtësive Çfarë shkathtësish duhet t'i zhvillojnë kompanitë e juaja?
Si do t'i adresojë ky trajnim boshllëqet në shkathtësi? (Tekst i shkurtër)

Seksioni 9: Të dhënat e planit të trajnimit (ju lutemi ofroni informata në lidhje me planin tuaj të trajnimit)

(ju lutemi ofroni tabela individuale më poshtë për trajnimet e ndryshme, kopjoni dhe replikoni (copy paste) tabelën sa herë që është e nevojshme).

Trajnimi 1

Kush e ofron trajnimin, cilët janë ofruesit e trajnimit?
Emrat e ofruesve të trajnimit: <i>(Nëse ofruesi i trajnimit është një nga ofruesit e trajnimit në kompani të konsorciumit, ju lutemi ofroni CV-të e trajnerëve).</i>
Çfarë trajnimi është ky dhe cila është metodologjia e trajnimit? • Rikualifikim - Mësimi i shkathtësive të reja në punë. • Përmirësimi i shkathtësive - Ndërtimi mbi shkathtësitë ekzistuese • Kombinim i të mësuarit teorik dhe praktik.
Emri i kursit:
Kohëzgjatja e kursit (orë-ditë?):
Numri i nxënësve që e ndjekin trajnimin:
Grupi i synuar? (Staf i ri apo aktual, etj.)

Cila është tema e trajnimit? (Përshkruani shkurtimisht)
Rezultati i pritshëm i të nxënit nga trajnimi:

Trajnimi 2

(...)

Seksioni 10: Zbatimi i trajnimit

(Ky seksion i referohet të gjitha trajnimeve të përshkruara në Seksionin 9, ju lutemi ofroni informata për të gjitha trajnimet)

Kur fillon trajnimi?
Kur përfundon trajnimi?
Vendi ku zhvillohet trajnimi?
Metodologjia e ligjërimit (me prani fizike, online, e përzier)
Kush e mbikëqyrë trajnimin?

Seksioni 11: Buxheti i trajnimit (referojuni formularit të buxhetit të bashkëngjitur në Shtojcën IV)

(format e buxhetit për te dy dritaret shkarkohet ne *ueb faqen* zyrtare te KIESAs te plotësohet dhe ngarkohet për aplikim).

Seksioni 12: Lista e shtojcave

Shtojca 1: Formulari i buxhetit

Ndarja e Buxhetit - Formulari i Aplikimit për Skemën e Granteve							
Nxitja e arsimit dual nëpërmjet promovimit të konsorciumeve ndërmjet institucioneve publike të AAP-së dhe kompanive të sektorit privat							
Dritarja 1							
#	Artikujt	Artikulli	Njësia	Vlera	Buxheti total	Kontributi nga partneri i konsorciumit	buxheti i skemës së granteve
1	Kostot direkte të projektit (Aktivitetet)						
1.1					-	-	-
1.2					-	-	-
1.3					-	-	-
1.4					-	-	-
1.5					-	-	-
	Totali i kostove direkte				-	-	-
2	Burime të trajnimit (Trajnime)						
2.1					-	-	-
2.2					-	-	-
2.3					-	-	-
2.4					-	-	-
2.5					-	-	-
	Totali i kostove të burimeve të trajnimit				-	-	-
3	Materiali dhe pajisjet (Listimi i materialit dhe pajisjeve të kërkuara)						
3.1					-	-	-
3.2					-	-	-
3.3					-	-	-
3.4					-	-	-
3.5					-	-	-
	Totali i materialit dhe pajisjeve				-	-	-
4	Kostoja për nxënësit që ndërlidhet me arsimin dual						
4.1	Kostoja e pjesëmarrjes së nxënësve						
4.2	Kostoja e transportit të nxënësve						
4.3	Kostoja e sigurimit të nxënësve						
4.4	Kostoja e kompensimit të nxënësve						
5	Shpenzimet tjera				-	-	-
5.1					-	-	-
5.2					-	-	-
5.3					-	-	-
5.4					-	-	-
5.5					-	-	-
	Totali i shpenzimeve të tjera				-	-	-
	Buxheti i përgjithshëm				-	-	-

Shënim:

- Kostot direkte të projektit përfshijnë të gjitha kostot dhe detajet e secilit prej artikujve që do të blihen sipas këtij granti të investimit. Aktiviteti përfshin çdo aktivitet që ndërlidhet me projektin dhe investimin e tij, p.sh. ngritja e një punëtorie.
- Burimi i trajnimit: të gjitha kostot që ndërlidhen me një trajnim të caktuar.
- Materiali dhe pajisjet: listimi i tërë materialit dhe pajisjeve që kërkohen.
- Shpenzimet tjera: çdo shpenzim tjetër që ndërlidhet me projekt-propozimin

Ndarja e Buxhetit - Formulari i Aplikimit për Skemën e Granteve

Mbështetje për kompanitë private (punëdhënësit) për të kontraktuar ofrues të akredituar të trajnimeve (duke përfshirë qendrat e trajnimit brenda kompanive) që ofrojnë arsim joformal afatshkurtër (kurse afatshkurtra)

Dritarja 2

#	Artikujt	Buxheti total	Kontributi nga partneri i konsorciumit	buxheti i skemës së granteve
1	Burimet e trajnimit	-	-	-
1.1	Trajnimi 1	-	-	-
1.2	Trajnimi 2	-	-	-
1.3		-	-	-
1.4		-	-	-
1.5		-	-	-
	Totali i kostove të burimeve të trajnimit	-	-	-
2	Materiali dhe pajisjet (Listimi i materialit dhe pajisjeve të kërkuara)	-	-	-
2.1		-	-	-
2.2		-	-	-
2.3		-	-	-
2.4		-	-	-
2.5		-	-	-
	Totali i materialit dhe pajisjeve	-	-	-
3	Shpenzimet tjera	-	-	-
3.1		-	-	-
3.2		-	-	-
3.3		-	-	-
3.4		-	-	-
3.5		-	-	-
	Totali i shpenzimeve të tjera	-	-	-
	Buxheti i përgjithshëm	-	-	-

Shënim:

1. Burimi i trajnimit: të gjitha kostot që ndërlidhen me një trajnim të caktuar.
2. Materiali dhe pajisjet: listimi i tërë materialit dhe pajisjeve që kërkojnë.
3. Shpenzimet tjera: çdo shpenzim tjetër që ndërlidhet me projekt-propozimin